



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**

---

Numri i lëndës: 2022:172737

Datë: 11.01.2024

Numri i dokumentit: 05176612

Ep.nr.232/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me, me ..... Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, ndaj debitorit M (M. G) M, me adresë në rrugën “J. A”, nr..., në P, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, P.nr./I.br.165/22, i datës 23.06.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 11.01.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit M.G, me adresë në rrugën “A. K”, nr..., në Pejë, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbartuesit Privat Z. B, me seli në P, P.nr./I.br.165/22, i datës 23.06.2022.

**A r s y e t i m**

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me, ..... Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, me datë 23.06.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 29.09.2021 deri me datën 18.05.2022, baza juridike borxh në vlerë prej 1315.45 Euro.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, me Urdhrin për Përmbartim P.nr./I.br.165/22, të datës 23.06.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori me datën 28.07.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor, duke theksuar: unë në këtë urdhër përmbartimor jam gabimisht i përfshirë sepse unë në atë shtëpi ku gjendet njehsori DPE 6634 nuk kam legjitimitet real pasiv. Shifra DPE 6634 evidentohet në emër të konsumatorit M.M.G, me adresë në rrugën “J.A”, nr.... Ndërsa unë jam M. A.G me adresë në rrugën “A. K”, nr...., andaj e kam jashtëzakonisht të paqartë se si është përfshirë numri im personal në këtë urdhër përmbartimor.

Nuk është kontestuese që në atë shtëpi kam banuar me qira para 16 konkretisht në vitin 2005 dhe kam dalur nga aty para 15 viteve dhe tani banoj në shtëpinë time e cila ka adresë në rrugën ”A K”, nr... në P, dhe kam shifër DPE:6632 dhe ndërsa detyrimi për shifrën DPE:6634 të cilën e kërkon kreditori është i një periudhe shumë të vonshme kohore dhe atë borxhi i krijuar nga data 29.09.2021 deri me 18.05.2022, periudhë kur dikur tjetër banon aty në fakt që edhe kreditori KESCO e ka të njohur sepse e faturon çdo muaj. Po ashtu dokumenti përmbartimor nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që është i përfshirë borxhi të cilin unë nuk e kam shpenzuar, pasi që nuk jetoj në atë shtëpi. Unë M. G jam pensionist, kam pension në shumën prej 100 euro jam i moshës së shtyrë 82 vjeçare dhe kam nevoja për trajtim të posaçëm shëndetësor. Duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Përfaqësuesi i kreditorit me datën 10.08.2022, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove prapësimin e debitorit. Sa i përket pretendimit të debitorit se borxhi është parashkruar as ky pretendim nuk qëndron pasi që kreditori në propozimin për përmbartim ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej 29.09.2021 deri me 18.05.2022, në shumën prej 1315.45 euro duke i bashkangjitur si provë faturat që janë lënë edhe tek konsumatori. Me datën 12.03.2022, debitori ka bërë pagesë në vlerë prej 327.00 euro, me çrast me pagesë vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit. Kërkesa për prapësim nuk është në përputhje me neni 69 par.4 të LPP-së, andaj debitori e ka paraqitur kërkesën për prapësim vetëm për arsye të zvarritjes dhe prolongimit të procedurës përmbartimore, duke i propozuar gjykatës që urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi ndërsa prapësimi të refuzohet.

Gjykata në procedurën përbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP), ka gjetur se prapësimi është tërësisht i bazuar.

*Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrit përbarimor dhe dokumentit të besueshëm.*

Në propozimin për përbarim të datës 23.06.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Z. B, me seli në Pejë, P.nr./I.br.165/22, të datës 23.06.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 29.09.2021 deri me datën 18.05.2022, në shumën prej 1315.45 Euro në emër të konsumit të energjisë elektrike.

Gjykata pasi ka vlerësuar provat e bashkangjitura kësaj lënde përbarimore ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsytet si në vijim:

Nga ekstrakti afarist për konsumin e energjisë elektrike në bazë të së cilit është iniciuar procedura përbarimore, me numër DPE-6634, si konsumator figuron debitori M(M.G)M, me adresë në rrugën J. A nr ...

Në Propozimin për Përbarim të datës 23.06.2022, në bazë të cilit edhe është nxjerr Urdhri për Përbarim nga Përbaruesi Privat Z. B, me seli në P, si debitor figuron M (M.G) M.

Gjykata pas shqyrtimit të ligjshmërisë së urdhrit përbarimor ka gjetur se urdhri përbarimor i përbaruesit privat, mbi bazën e së cilës ka filluar procedura përbarimore, është i paligjshëm, pasi një urdhër i tillë i lëshuar mbi bazën e një propozimi për përbarim në të cilin janë të përfshirë dy emra-persona fizik, nuk mund të konsiderohet i rregullt pasi që krijon konfuzitet dhe paqartësi se cili nga ta personi M. M apo personi M. G është debitori në këtë çështje përbarimore.

Sipas nenit 43 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Në aktvendimin për përbarimin dhe urdhrin për përbarim në bazë të titullit përbarues duhet të tregohet dokumenti përbarues, kreditori dhe debitori i përbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*.

Kësisoj, në këtë rast gjykata ka gjetur se ekziston paqartësi se kush është debitor në këtë procedurë përmbarimore, pasi që urdhrin përmbarimor dhe në dokumentin e besueshëm janë cekë dy emra në cilësi të debitorit, andaj kjo paqartësi krijon mangësi të pakapërcyeshme në zhvillimin e drejtë të procedurës përmbarimore, e cila kushtëzon në shfuqizimin e urdhrin përmbarimor pasi që nuk mund të dihet se cili nga personat e cekur në propozimin për përmbarim është debitori dhe rrjedhimisht personi i cili ka legjitimitet real pasiv për të u zhvilluar procedura përmbarimore për çështjen e borxhit të akumuluar për furnizimin me energji elektrike.

Andaj, gjykata duke u kujdesur në garantimin e ligjshmërisë të urdhrave përmbarues, ka gjetur se një urdhër i tillë nuk plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në dispozitat të LPP-së, dhe atë bazuar në nenin 43 par.4 të LPP-së që përcakton: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Duke qenë se gjykata ka gjetur se urdhri përmbarimor nuk plotëson kushtet për përmbarueshmëri, atëherë nuk ka pasur mundësi të shqyrtojë edhe pretendimet të tjera të debitorit, pasi pretendimet tjera do të mund të shqyrtoheshin nga gjykata vetëm nëse urdhri për përmbarim do të ishte i ligjshëm.

Ndërsa sa i përket kundërshtimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim lidhur me parashkrimin e borxhit, gjykata i vlerëson si jo relevante, pasi që debitori në prapësimin e tij nuk është thirrur fare në parashkrimin e borxhit.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 43 par.1 dhe 4 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:172737  
Ep.nr.232/2022, me datë 11.01.2024.

Gjyqtarja

---

Blerta KELMENDI

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh  
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.